



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 423/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Emilija Rexhepi kryetare e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisionit Komunal Zgjedhor në Prizren (KKZ), për shkak të emerimit të anetareve të KKZ-së, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Emilija Rexhepi kryetare e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS).

#### Arsyetim

PZAP-i, më datë 01.11.2013 ka pranuar një ankesë nga Emilija Rexhepi kryetare e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), në të cilën theksohet se KQZ ka emeruar KKZ për komunën e Prizrenit për zgjedhjet lokale. KQZ me këtë vendim edhe pse është e obliguar në baze të LZP-se dhe LZL, nuk e ka emeruar anëtarin e NDS-se për anetare të KKZ-se dhe kështu ka shkelur seriozisht ligjet e lartë përmendura dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 67 i LZP-se përcakton qartë “ KQZ do të përmbahet, në mes tjerash nga një anetare të emeruar nga rradhet e subjekteve politike të cilat e kanë kaluar pragun zgjedho.

NDS poashtu kundërshton vendimin e KQZ-se për emerimin e anetareve të KKZ-se për Prizren dhe me këtë vendim KQZ-ja i ka shkelur nenet si në vijim: 67.d); 67.3, 69.3 dhe 69.6 të LZP-se. Subjekti politik NDS me këtë ankesë kërkon nga PZAP-i që të rishqyrton vendimin e KQZ-se dhe KKZ-se dhe që të vepron sipas neneve të lartë përmendura dhe ta urdhëron KQZ që ta rishqyrtoj vendimin e marrë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

#### Ankesa është e pabazuar

Ankuesi në ankesë pretendon se KQZ nuk ka emeruar në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë proporcionale anëtarët e KKZ-se. PZAP-i gjeti se ankesa e NDS-se është e pabazuar për faktin se në ankesë nuk janë dhënë prova dhe dëshmi të mjaftueshme të cilat eventualisht do të argumentonin pretendimet e tilla ankimore pasi që me këtë

rast pala ankuese nuk ika bashkangjitur ankese prova te mjaftueshme për tu vërtetuar pretendimet e tilla ankimore andaj ankesa në fjale është e pabazë dhe një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si përgjithshëm dhe i pa argumentuar mirë në fakte dhe në dëshmi konkrete bindëse. Andaj PZAP-i duke u mbështetur në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 423/2013 më datën 04.11.2013

**Kryesuesi i Panelit**  
**Nehat Idrizi**



***Këshillë Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*